



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË SOCIALISTE

Nr. 999 Prot.

Tiranë, më 06 / 03 / 2026

Lënda: Kërkesë për marrjen e masave disiplinore

Drejtuar: **Z. NIKO PELESHI**
KRYETAR I KUVENDIT TË SHQIPËRISË

SEKRETARIATIT PËR PROCEDURAT, VOTIMET DHE ETIKËN

Baza Ligjore: Neni 63 dhe neni 65/1 pika 1 dhe pika 6, të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë;
Neni 6 i Kodit të Sjelljes së Deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

I nderuar zoti Kryetar i Kuvendit,

Të nderuar anëtarë të Sekretariatit për Procedurat, Votimet dhe Etikën

Në Seancën e Kuvendit të Shqipërisë të datës 5 Mars 2026, gjatë fjalës së Kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste mbi një marrëveshje dhe procesin e anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Europian, deputetë të Grupit Parlamentar të PD kanë ndërhyrë herë pas herë nga salla me thirrje dhe provokime dhe më pas kanë bllokuar fjalën e folësit në foltore, me pretendimin se gjatë fjalës është përdorur gjuhë joparlamentare dhe diskriminuese.

Pra, këta deputetë të Grupit Parlamentar të PD nuk kanë pritur drejtuesin e seancës, i cili është i vetmi që ka autoritetin të interpretojë Rregulloren në këtë rast, por kanë kaluar në shkelje të rënda të Rregullores, të cilat mund të verifikohen në pamjet dhe regjistrimet audio të bëra publike.

Pas bllokimit të foltores së Kuvendit dhe ndërprerjes së Seancës, me rifillimin e saj Kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste ka kërkuar të vazhdojë fjalën e ndërprerë në mes dhe menjëherë ka sqaruar kontekstin e shkëmbimit të replikave me deputetët që flisnin nga vendi, shoqëruar edhe me ndjesën për çdo keqkuptim të mundshëm, siç parashikohet nga Rregullorja dhe Kodi i Sjelljes së Deputetit.

Por qoftë gjatë fjalës në foltore, edhe gjatë vijimit të fjalës për sqarimin pasues, ne kemi qenë dëshmitarë të një situate shumë të rëndë ku veçanërisht deputetët Gazment Bardhi dhe Klevis Balliu janë përfshirë në akte dhune, tentativa për të goditur folësin, gjuhë joparlamentare dhe dëmtim të pajisjeve (mikrofoni dhe sistemi i votimit) dhe kanë hequr funksionalitetin e tyre logjistik.

Këta dy deputetë, të mbështetur nga kolegë të tjerë, me sjelljet e tyre tepër agresive penguan, cënuan rendin dhe zhvillimin normal të seancës plenare, bllokuan foltoren, nuk lejuan vijimin e fjalës së deputetëve, sjellje këto në kundërshtim me Rregulloren e Kuvendit dhe Kodin e Sjelljes së Deputetit.

Siç verifikohet nga pamjet video dhe regjistrimet audio, bashkangjitur kësaj kërkesë, por edhe nga publikimet në media, deputeti Gazment Bardhi jo vetëm që përdori fjalë fyese të rënda dhe të drejtëpërdrejta, por edhe pas këtyre veprimeve dhe tërheqjes së vëmendjes disa herë nga Drejtuesi i Seancës ky deputet nuk tregoi pendesë dhe nuk kërkoi falje për gjuhën joparlamentare të përdorur, duke e rënduar pozitën e tij në raport me Rregulloren në mënyrë të përshkallëzuar, sipas neneve 64 pika 1 (a), 64/1 pika 1 (a), 64/2 pika 1, pika 2 etj.

Sipas pamjeve video dhe regjistrimeve audio, bashkangjitur kësaj kërkesë, por edhe nga publikimet në media, deputeti Klevis Balliu përdori fjalë të rënda dhe kërcënuese, tentoi të godasë deputetët dhe dëmtoi pajisjet (mikrofoni dhe sistemi i votimit) dhe ka hequr funksionalitetin e tyre logjistik. Pas këtij veprimi të rëndë, ndaj deputetit Klevis Balliu Drejtuesi i Seancës mori si masë disiplinore paraprake "heqjen e së drejtës së fjalës", bazuar në nenin 64/2 pika 2.

Për sa më sipër, bazuar në provat filmike bashkëshoqëruese, pamjet e bëra publike nga mediat, *bazuar në nenin 63, dhe nenin 65/1 pika 1 dhe pika 6, të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë të ndryshuar; dhe nenit 6 të Kodit të Sjelljes së Deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë*, paraqesim kërkesën si më poshtë:

1. Marrjen e masës disiplinore "Përfjashtim nga pjesëmarrja në komisione dhe në seancë plenare" për 10 ditë referuar nenit 65/1, pika 1, për deputetin Gazment Bardhi i cili ka penguar zhvillimin e rregullt të seancës, ka shkaktuar kaos në sallë, ka përdorur fjalë shumë të rënda fyese dhe kërcënuese ndaj deputeteve të Partisë Socialiste dhe drejtuesit të seancës.
2. Marrjen e masës disiplinore "Përfjashtim nga pjesëmarrja në komisione dhe në seancë plenare" për 30 ditë referuar nenit 65/1, pika 1, për deputetin Klevis Balliu i cili ka penguar zhvillimin e rregullt të seancës, ka shkaktuar kaos, ka përdorur fjalë të rënda fyese dhe ka shfaqur sjellje agresive të përsëritura, si dhe referuar pikës 6 të po këtij neni, me veprimet e tij të qëllimshme ka dëmtuar pajisjet dhe ka hequr funksionalitetin e tyre logjistik.

1 Evis Juski 

2 ~~Samir Zuko~~ 

3 Anuberto Sheme 

4 SARA MILA 

5 Marijona Kozek 

6 BORA MUHAMMAD 

7 Olta Xhacha Oluhmedaj 

8 Juri Luvran 

9 Kioluina Zaka 

10. ZESA SODU 

11. Miro Golec 

12. Ami Dymshu 

13 Asford 

14. Evis 

15. Evis Ismaili 

16 Elera Badini 

17. Anna Nako 

18. Alana Selami 